*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F525RED dhe F631*

E mërkurë, 30 maj 2023

[Seancë e hapur]

[I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

--- Seanca fillon në orën 09.30

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirdita. Mirë se keni ardhur.

Z. Sekretar i Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-04, Prokuroria i Specializuar kundër Pjetër Shalës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të fillojmë me paraqitjen e ZPS-së.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Sot ZPS-ja, paraqitet nga z. Alex Whiting, Prokuror i Specializuar në detyrë; znj. Line Pedersen, menaxhere e lëndës; Giulia Bianchi, stazhiere; Gaia Pergolo dhe unë, Filippo De Minicis, Prokuror.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Përfaqësues i Viktimave.

Z. LAWS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Më quajnë Simon Laws, së bashkë me Maria Radziejowska, për viktimat.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Avokat, keni të drejtën të paraqiteni.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Mirëdita. Më quajnë Jean-Louis Gilissen. Së bashku jam me Hedi Aouini. Jam znj. Dzeneta Petravica, jemi dhe me Juliette Healy dhe Judit Kolbe, kemi dhe Xhulia Tepshi, stazhiere dhe përkthyese.

Dhe, sigurisht, z. Shala është i pranishëm përmes videolidhjes nga qendra e paraburgimit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Shala, mirëmëngjes. A mund të konfirmoni që më dëgjoni mirë?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes. Ju dëgjoj shumë mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Sot, do të vijojmë me paraqitjen e provave nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. Sot do të dëgjojmë dëshminë e Dëshmitarit numër 1 të ZPS-së.

Parimisht, do të zhvillojmë seancat normale. Pra, do të bëjmë seanca një orë e gjysëm me pushime 30 minutëshe, pastaj do të bëjmë dhe pushimin 90 minutësh për drekën. Megjithatë, nëse do të shohim se për dëshmitarin do të jetë më mirë që të bëjmë seanca më të shkurtra, do ta bëjmë këtë vlerësim në vijimësi për të parë nëse është e nevojshme. Nuk e di mbase seanca 45 minutëshe, nëse kjo do të ishte më e mirë për

dëshmitarin. Të shohim si do të jemi.

Përpara se të fillojmë me dëshminë e dëshmitarin, i lutem Sekretarit të Gjykatës që të na kalojë, shumë shkurt, në seancë private sepse dëshiroj që të diskutoj diçka.

~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur] *Riklasifikuar në bazë të F631*

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private, të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Sekretar.

Trupi Gjykues u informua javën që shkoi se Zyra Administrative bëri një takim kortezie midis Dëshmitarit 1 dhe ZPS-së, pa praninë e personelit të Zyrës së Dëshmitarëve. Kjo nuk është në përputhje me vendimin tonë për informimin në tërësi të dëshmitarëve, parashtrim i protokolluar 435, paragrafi 25.

Kjo ka qenë pasojë e një keqkuptimi të personave të pranishëm dhe kjo zgjati vetëm pak minuta. Gjithsesi kjo nuk është në përputhej me vendimin tonë, siç e përmenda dhe Trupi Gjykues i urdhëron të gjithë që të ndjekin udhëzimet tona.

Për arsye të transparencës, Trupi Gjykues e konsideron të përshtatshme që të informojë Mbrojtësin e Viktimave dhe Avokatin e Mbrojtjes se kjo ka ndodhur dhe mund t'ju japim fjalën, nëse dëshironi, që të ngrini ndonjë diçka lidhur me këtë.

Sepse transparenca është një prej gjërave të cilën e

respektojmë sa më shumë në këtë proces gjyqësor.

Në fillim ia jap fjalën Mbrojtësit të Viktimave, pastaj Avokatit të Mbrojtjes.

Z. LAWS: [Përkthim] Asgjë për të thënë për këtë. Por dëshiroj që të ngre diçka tjetër të shkurtër pas kësaj.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në seancë private apo publike?

Z. LAWS: [Përkthim] Në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Avokat i Mbrojtjes.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës. Edhe neve, sigurisht, na vjen keq për këtë keqkuptim. Nëse ka diçka që ia vlen që të na informojnë, jam i sigurtë që pala tjetër do të na informonte.

Ne, sigurisht, kemi qenë në diskutim me ata për të na dhënë dokumente për t'u përgatitur. Për këtë nuk dëgjuam gjë. Por, ne po vijojmë në bazë të supozimit se çfarë ishte për të informuar do të informohet.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Prokuroria ka gjë?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo. Çdo gjë është thënë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Shumë mirë. Përpara se të kthehemi në seancë publike, ia jap fjalën Mbrojtësit të Viktimave.

Keni fjalën.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Kjo ishte sa i takonte pikës së dytë.

Po pika e parë ishte takimi i kortezisë dhe keqkuptimi lidhur me mungesën e Zyrës së Dëshmitarëve.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Me kënaqësi ia vë në dispozicion shënimin hetimor Mbrojtjes në çdo moment.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Tani mund të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit.

Znj. Sekretare, ju lutem të sillni dëshmitarin në sallë.

Do të dëgjojmë dëshminë e Dëshmitarit 1 të Prokurorisë këtu në sallë të gjyqit drejtpërdrejt.

[Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Uluni ju lutem, Dëshmitar.

Mirëmëngjes, z. Dëshmitar.

DËSHMITARI: Mirëmëngjes.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se erdhët në Dhomat e Specializuara të Kosovës. A më dëgjoni?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

Shala, a e dëgjoni dëshmitarin?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e shoh dhe e ndëgjoj shumë mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, z. Shala merr pjesë në seancë përmes videolidhjes. Ju jeni informuar për këtë gjë.

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, si jeni sot?

DËSHMITARI: Mirë. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

Sot do të fillojmë me dëshminë tuaj. Përpara se të fillojmë, kam disa gjëra për t'i thënë, së pari do t'ju shpjegoj masat mbrojtëse që u janë miratuar.

Ju është miratuar pseudonim. Ju është caktuar një pseudonim që do të thotë se do t'ju drejtohemi në sallën e gjyqit vetëm me "Z. Dëshmitar". Në këtë mënyrë sigurohemi që publiku të mos e dijë emrin tuaj. E di që këtë e keni të qartë meqë pohoni me kokë.

Gjithashtu do të ketë edhe ndryshim të pamjes dhe zërit, kjo do të thotë se askush jashtë sallës nuk mund ta shikojë fytyrën apo të dëgjojë zërin tuaj të vërtetë gjatë dhënies së dëshmisë.

Kur të përgjigjeni në pyetje që nuk zbulojnë identitetin

tuaj, atëherë do të punojnë seancë publike si tani. Kjo i mundëson publikut që të dëgjojë gjërat që thuhet në këtë sallë gjyqi.

Por kur do t'ju kërkohet që të përshkruani ndonjë gjë që lidhet konkretisht me ju apo të përmendni fakte që mund të zbulojnë identitetin tuaj, atëherë këtë do ta bëjmë seancë private. Kjo do të thotë se nuk ka transmetim jashtë sallës së gjyqit dhe as kush janë jashtë sallës së gjyqit nuk mund të dëgjojë atë që thuhet këtu.

Në qoftë se diçka thuhet në seancë publike që mund t'u identifikojë, ne këtë informacion do ta mbrojmë. Kjo do të thotë, që ne për këtë qëllim e transmetojmë këtë seancë me vonesë, gjatë asaj vonese mund të hiqet çdo informacion që nuk duhet të nxirret jashtë sallës së gjyqit për publikun dhe gjithashtu mund të hiqet edhe nga transkripti publik i seancës.

Të gjitha këto masat mbrojtëse, a i ke të qarta, z. Dëshmitar?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Jeni i ftuar për të dhënë dëshmi, z. Dëshmitar, para Dhomave të Specializuara të Kosovës në çështjen Prokurori kundër z. Pjetër Shala për ta ndihmuar Trupin Gjykues për të marrë vendimin e duhur. Së pari, do t'ju kërkoj që të bëni

deklaratën solemne për ta thënë të vërtetën. Dhe pastaj do t'ju bëhen pyetje nga Prokurori, këto janë avokatët që janë të veshur me teshat ngjyrë vjollcë, në anën tënde të majtë. Dhe më pas pyetjet do t'i bëjë avokati që përfaqëson viktimat në këtë çështje, është avokati i ulur afër avokatëve të Prokurorisë. Dhe pastaj do t'ju bëjnë pyetje edhe mbrojtësit, avokatët e Mbrojtjes së z. Pjetër Shala, që janë të ulur në anën të djathtë me teshat me të kuqe. Dhe, në fund, mund të bëjnë pyetje edhe Gjykatësit që i keni përballë.

Do t'ju jap disa udhëzime në lidhje me mënyrën si do të përgjigjeni pyetjeve që do t'ju bëhen.

Dëshmitar, duhet të dëgjoni me kujdes çdo pyetje që do t'ju bëhet. Në qoftë se nuk e kuptoni pyetjen, mund të kërkoni lirisht që pyetja t'ju përsëritet.

Duam që të na e thoni të vërtetën dhe të na tregoni atë që keni parë ju, atë që e keni dëgjuar ju, atë që e keni përjetuar ju vetë. Në qoftë se diçka nuk e keni parë, dëgjuar apo ndjerë vetë, atëherë duhet të na e bëni të ditur këtë. Për ne është me rëndësi që të dimë se çka keni pa ju vetë apo çka keni ndëgju ju vetë.

Ndoshta nuk ju kujtohen të gjitha hollësitë e ngjarjeve dhe kjo është krejtësisht në rregull. Në atë rast vetëm na thuaj "Nuk e di", "Nuk më kujtohet". Kjo përgjigje nuk është kurrfarë problemi.

Dhe, në fund, përgjigjuni pyetjeve që ju bëhen. Në qoftë

se na duhet ndonjë hollësi, atëherë do t'ju japim mundësi që të plotësoni përgjigjen, por përmbajuni pyetjes që ju bëhet në përgjigjen tuaj.

Ka edhe një aspekt praktik të dëshmisë që dua ta ndaj me ju. Çdo gjë që thuhet sot në sallë të gjyqit përkthehet nga përkthyesit që janë në kabina këtu lart dhe regjistrohet nga stenografi. Prandaj është me rëndësi që të flisni drejtpërdrejt në mikrofon, të flisni ngadalë dhe të flisni qartë.

Duhet të filloni të flisni vetëm atëherë kur personi që ua bënë pyetjen ka përfunduar me pyetjen, për ta bërë këtë më së miri është, në qoftë se mundesh, që në vetvete të numërosh deri në pesë dhe pastaj të fillosh me dhënien e përgjigjes. Këto pesë sekonda janë shumë me rëndësi meqë përkthimi duhet të përfundohet përpara se përkthyesit të fillojnë me pjesën në vijim që duhet të përkthehet.

Në qoftë se e ngre dorën kështu, atëherë të lutem të ndërprehesh me të folur. A e ke të qartë?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Ndonjëherë mund të jetë e nevojshme që ne të diskutojmë ndonjë aspekt që lidhet me përmbajtjen e dëshmisë suaj, na kanë informuar që nuk flisni anglisht dhe në ato raste do të kërkoj që t'i hiqni ndëgjueset në mënyrë që të sigurohem që ajo që diskutohet prej nesh nuk do të kuptohet

prej jush.

Në qoftë se ke nevojë për ndonjë pushim apo për ndihmë apo dëshiron t'i drejtohesh Panelit të Gjykatësve me ndonjë pyetje, atëherë mund të ngresh dorën dhe unë do ta jap fjalën për ta diskutuar atë që e mendon se është e nevojshme.

A i kuptove i gjitha këto që t'i thashë, Dëshmitar?

DËSHMITARI: Po. I kuptova të gjitha.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë. Atëherë, tani do të kërkoj që ta bësh deklaratën solemne për ta thënë të vërtetën. Sekretarja e sallës së gjyqit do të ndihmojë.

Të rikujtoj se është vepre penale në juridiksionin e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhënia e dëshmisë së rreme. A e keni të qartë këtë, z. Dëshmitar?

DËSHMITARI: Po. Krejt e kam të qartë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Tekstin e deklaratës ua ka dhënë Sekretarja.

Tani mund ta lexoni deklaratën solemne, z. Dëshmitar. Mund të qëndroni i ulur, s'ka nevojë të çoheni në këmbë.

DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm/e ndërgjegjshme me rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

DËSHMITARI: TW4-01

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Dëshmitar. Tani je nën betim për të thënë të vërtetën. Dhe e shoh që pohon me kokë. Në rregull.

Përpara se të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit 1, ka një gjë që duhet të thuhet për publikun për arsye të mbrojtjes së dëshmitarit parashikojmë që pjesa më e madhe e dëshmisë së këtij dëshmitari të jepet në seancë private në mënyrë që të mbrohet identiteti i dëshmitari.

Paneli më pas do ta rishikojë dëshminë dhe do të gjykojë se cilët pjesë mund të nxirren për publikun.

Z. Prokuror, tani ju jap fjalën të filloni me pyetjet për dëshmitarin.

Dëshmitar, tani pyetjet do të filloj t'jua bëjë Prokurori.

Z. Prokuror, keni kërkuar 12 orë për pyetjet për këtë dëshmitar. A ka ndonjë ndryshim në këtë parashikim të kohës, ju lutem ta informoni Trupin Gjykues nëse do të ketë ndonjë ndryshim në këtë drejtim.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Do të bëjmë çmos që t'i rishikojmë parashikimet tona për kohën sikurse edhe i bëjmë pyetjet.

Pyetje nga Z. De Minicis: [Përkthim]

PY. Mirëmëngjes, z. Dëshmitar. Mirë se erdhët. Sikurse ua shpjegoi edhe Gjykatësja, identiteti juaj është i mbrojtun. Do

të filloj me disa pyetje që kanë të bëjnë me të dhënat tuaja personale dje do të kërkoj nga Gjykatësja që të kalojmë në seancë private.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Sekretar, të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

PY. A i ke dhënë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ndihmë në një farë lloji ose forme për jashtë?

PË. Kam pasë kontakte dhe ju kam ndihmu.

PY. A mund të na japësh një shembull, për shembull, se çfarë lloj ndihme ose përkrahje i ke dhënë UÇK-së?

PË. Kam pasë raste se i kam ba vendstrehimit, pushim, kësi gjena.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

PY. Shoferit të këtij automjetit a i kërkut që me ju çu në një vend të caktum aty në Kukës?

PË. Jo. Shoferi ka qenë tuj shku për në Kukës, ka dashtë me shku, atëherë e lutëm na për me na çu në Kukës. Edhe na ka zbrit vetëm në Kukës, na ka lënë dhe asgjë tjetër.

PY. A ju kujtohet se ku pikërisht në Kukës zbritët nga automjeti? Në cilën pjesë të qytetit diku më konkretisht?

PË. Ka qenë, sa më kujtohet, ka qenë afër një spitalit aty dhe janë kanë do shatore për të ikmit se kanë qenë pi lufte afër aty.

PY. Tani u ndodhët në Kukës, mbërritët në Kukës *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* sapo ju kishin dëbu prej

Kosove. Çfarë kishit në kokë? Çfarë kishit ndërmend të bënit? Ku do shkonit?

PË. Unë kam pasë ndërmend ashtu-kështu për me u vesh me u mobilizu për UÇK-në.

PY. Përse e vendosët tani t'i bashkoheshit UÇK-së ndërkohë që deri në maj të vitit 1999 nuk i ishit bashku UÇK-së?

PË. Nuk ma ka marrë mendja se s'i kam pasë shanset deri në atë kohë.

PY. Ka ndonjë arsye pse s'ua kishte marrë mendja që mund të bashkoheshit me UÇK deri atëherë?

PË. Nuk e di si me ta spjegu. Po a kanë edhe pak problem. Edhe është dashtë me njoftë dikën për me i besu për me u veshë.

[Seancë private]
[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike, të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Sekretar.

Z. Dëshmitar, është momenti tani për të bërë pushimin prej 30 minutash. Do t'i kërkojë Asistentes së sallës që t'ju shoqërojë të dilni nga salla, do të rishihemi këtu në orën 11.30. Faleminderit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Kemi pushimin 30 minuta dhe rishihemi në orën 11.30.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të gjithë në këmbë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Bëjmë një ndërprerje të seancës këtu.

--- Pauza fillon në orën 11.00

--- Seanca rifillon në orën 11.30

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Uluni, ju lutem.

Mirë se erdhët përsëri. Nuk shoh ndonjë ndryshim në përbërjen e Zyrës së Prokurorisë, as në atë të Mbrojtësit të Viktimave e as në ekipin e Mbrojtjes.

E shikoj që edhe z. Shala është i pranishëm.

A na dëgjon z. Shala?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju dëgjoj shumë mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Atëherë do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 1.

Znj. Sekretare ju lutem të sillni dëshmitarin në sallë

Z. DE MINICIS: [Përkthim] E kam referencën e asaj që përmenda më herët *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ndoshta më mirë që këtë informacion ta kemi në seancë private.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Do ta kemi këtë parasysh dhe për çdo parandalim të daljes së informacionit duhet t'i marrim masat e duhur.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëherë do ta bëjmë këtë kur të kalojmë në seancë private.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, a më dëgjon?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Mirë se u ktheve përsëri në sallë. Do të vazhdojmë me pyetjet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

Z. Shala a e dëgjove dëshmitarin?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e dëgjoj edhe e shoh mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Atëherë tash do t'ja jap fjalën Prokurorit që të vazhdojë me pyetjet e veta.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse, duhet të kalojmë përsëri në seancë private. Shpresoj që të mund të kaloj në seancë publike për t'i bërë disa pjesë të pyetje në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëherë të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Mirë se erdhe përsëri Dëshmitar. Përpara se të shkonim në pushim na tregove sesi mbërrite në shtabin në Kukës. Kur mbërritët aty, mbasi *[REDAKTUAR]*a kishit pru me vete ndonjë valixhe, ndonjë gjë, ndonjë torbë?

PË. Po.

PY. Po a kishit mundësi që ta linje atë valixhe dikund në momentin kur hytë aty në shtab? A kishit ndonjë vend ku e latë valixhen?

PË. E kemi lanë q'aty në magazinë ku ka qenë uniforma.

PY. Mbasi mbërritët q'aty në shtab, e latë uniformën - më fal - e latë valixhen në magazinë, a e pe dikën që e njihshe?

PË. Po kur kam hi në oborr e kam njoft njoh. Ka qenë *[REDAKTUAR]* në oborr, po nuk jam taku më, jam përshëndet. Edhe Pjetër Shala kur ka ardhë në magazinë me një shok të vet. E ka një shenjë në fytyrë. Nga ana e Suharekës është. Jeton në Zvicër tash.

PY. Ku për herë të parë e takove Pjetër Shalën aty në shtab? Ku në cilin vend?

PË. Atë ditë se ka ardhë në shtab, q'atë mbrëmje ka ardhë mbasdite, ka ardhë në magazinë aty edhe aty ka fjetë.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

PY. Në atë moment, a e ke ditur në qoftë se Pjetës Shala njiheshe aty me ndonjë nofkë apo me ndonjë pseudonim lufte?

PË. Sa kam qenë para se me ardhë unë hala në Shqipëri, unë e kam ditë se thirret Ujku.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Mund të vazhdoni Prokuror.

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, na treguat sesi në muajin maj 1999 arritët në shtabin në Kukës me njerëzit që ishin me ju dhe na treguat se aty e takuat Pjetër Shalën. Tani do të përpiqem që të vazhdojmë duke i dhënë Trupit Gjykues një përshkrim të atij vendi aty. Këtë do ta bëj me anë të disa pyetje por gjithashtu

do të përdori edhe disa vizatime që i kemi bërë në të kaluarën dhe fotografi.

A mund të -- në fillim me fjalët tuaja t'ia përshkuar Trupit Gjykues sesi dukeshte ky vend?

PË. Po, shumë lehtë është. Është si të hish në shtab është rampa më së pari. Si të hish në oborr, ballë për ballë si të hish në oborr e ke magazinën është e gjatë, e lartë. Ka pasë lartësi të naltë po njëkatëshe. Ka pasë në mes e ka pasë edhe një derë të hekurit se e ka da magazinën e ushqimit me magazinën e uniformave se kam qenë te magazina e uniformave. Tri dyert të hekrit krejt i ka pasë. Domethënë këtej-këtej edhe një në mes përmbrenda.

Shtabi ku kanë qenë zyrat, ku kanë qenë, si të ishte rampa në anën e majtë, kanë qenë zyrat edhe dhomat ç'ka ka pasë në të dytin kat, s'kam qenë. Në fund të fundit aty ka qenë kuzhinë, në anën tjetër në të majtë. Në anën e djathtë kanë qenë dhomat ku kam qenë unë i mbyllun mbasi më kanë ndërru vendin. Domethënë, në anën e djathë kanë qenë dhomat ku kam qenë i mbyllur, kur më kanë çu në atë dhomë.

PY. Faleminderit.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për qartësi, në lidhje me këtë përshkrim të saktë që e dha dëshmitari, propozoj që të shikojmë një vizatim që e ka bërë vetë dëshmitar gjatë një interviste që është bërë në të kaluarën. Dëshmitari pastaj mund me anë të këtij vizatimi të

na tregojë se cilat janë ndërtesat specifike.

A mund ta vendosim në ekran provën me numër SITF00012876 deri në SITF00012878.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sekretar, ju lutem vendosni këtë provë në ekran.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Është në faqen e tretë të këtij dokumenti. Po, kjo është.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dëshmitar, a e sheh këtë vizatim në ekran përpara?

DËSHMITARI: Po.

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, nga ana e djathtë lart ka një datë, nuk do ta lexoj se jemi në seancë publike dhe përfundi datës ka një nënshkrim. A e ke të njoftun këtë nënshkrimin?

PË. Po, fort mirë.

PY. I kujt është?

PË. Imi.

PY. Këtu ke vizatuar një vend dhe ndërtesat aty janë të shënume ndonjëherë edhe në gjuhën shqipe dhe në gjuhën anglishte dhe tregojnë se çfarë kanë qenë ato ndërtesa. Thatë që ka pasur një farë dere kryesore për të hyrë. A mund të na e shënoni me shkronjën "A" vendin e derës kryesore të shtabit?

PË. [Shënon]

PY. A mund ta shënojsh me shkronjën "A"?

PË. Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E shikojmë një rreth dhe përfudni rrethit një shkronjë "A"

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ashtu është.

PY. Tani, Dëshmitar, me shkronjën "B" a mund ta shënosh magazinën ku i ke lënë teshat dhe ku e ke taku Pjetër Shalën fillimisht?

PË. [Shënon]

PY. Aty në të majtë është magazina e teshave dhe këndej në të djathtë e ke shënu "Magazina e ushqimit". Këto dy magazina kanë qenë të lidhura me njëri-tjetrin. A ke mund me hec pushim kur ke qenë prej njërës magazinë te tjetra?

PË. Ke mujt pa dalë hiç jashtë se e ka pasë derën përmbrena.

PY. Në të majtë të kësaj derës kryesore, portës kryesore, shkruan "kati i dytë" edhe "shtabi". A mund t'i tregojsh Gjykatësve se çfarë është kjo ndërtesë këtu?

PË. Këtu poshtë janë zyrat, ka qenë një ordinancë e vogël e mjekut edhe zyrat, komandandanta ç'ka kanë frytëzu. Edhe nalt e di se ka pasë disa dhoma të tjera, qysh kam ni, se në të dytin kat s'kam qenë asnjëherë.

PY. Mendoj që me kaq e kemi mbulu pak a shumë ditën e parë mbas mbërritjes tënde aty në atë shtab. Natën e parë, ku ke fjete, a mund me "X" ta shënojsh vendin ku e ke kalu natën e parë?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dëshmitar, përpara --

DËSHMITARI: [Shënon]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] -- se të përgjigjesh, dua që ta pyes diçka Prokurorin.

Kjo ndërtesa e fundit, dëshmitari nuk e ka shënuar me ndonjë shkronjë. Mendoj që është mirë të shënohet në mënyrë që të mund më kollaj t'i referohemi më vonë.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit që ma përkujtuat, Gjykatëse.

PY. Dëshmitar, na përkujtoi Gjykatësja se nuk e kemi shënuar me ndonjë shkronjën atë ndërtesën ku shkruan shtabi edhe kati i dytë. A mund këtë ndërtesë ta shënojsh me shkronjën "C".

PË. C.

PY. Iu përgjigje pyetjes time dhe e shënove me "X" atë vendin që e shënove paras. A është ky vendi ku e ke kalu natën e parë?

PË. Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Prokuror, sa për të qenë të saktë, në përmbledhjen e juaj se çfarë kishte sjellë me vete dëshmitari, ju përmendët tesha që i kishte lënë në magazinë. Ju thatë fjalën "valixhe", sa për referencë.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatëse.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund të vazhdoni.

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Tani, Dëshmitar, ju bëna pyetje se çfarë ndodhi ditën e parë. Tani do t'ju pyes kështu: Çfarë bëtë ditën e dytë? A ju kujtohet se çfarë bëtë aty ditën e dytë?

PË. Ditën e dytë kena nejt me të njëjtit njerëz. Me Pjetrin, janë konë edhe një i policisë ushtarake edhe një ushtar tjetër. Ka mbrëmja kena lujt edhe letra. Edhe kemi fjetë.

PY. Edhe atë ditë, pra, ditën e dytë, a ke qenë në gjendje të lëvizish lirisht aty brenda shtabit, domethënë për shembull me dalë prej magazinës në oborr? A ke mund me lëviz lirshëm atë ditë?

PË. Jo, s'më kanë lënë një herë me dalë se ishin konë tuj verifiku për ne, e ne s'e kemi ditë.

PY. A do të thotë kjo që s'ke mujt me dalë prej magazinës, domethënë që ke mujt me lëviz vetëm brenda ndërtesës së magazinës, jo me dalë jashtë?

PË. Vetëm brenda magazinës.

PY. Na tregove që ke qenë aty me Pjetër Shalën dhe ka pasë disa policë ushtarakë dhe se në mbrëmje keni lujt letra. A ka pasë edhe njerëz të tjerë aty në magazinë që ti ke mujt me i pa? Pra, atë ditën e dytë?

PË. Po, i kam pa këta që janë marrun me atë magazinën tjetër të ushqimit. Ka qenë një i Vërmicës, se ai ka qenë i uniformave dhe shkojke në magazinë të ushqimit. Dhe një tjetër, se s'e di qysh e ka emrin.

PY. Po edhe ndonjë tjetër që ka qenë aty tuj qëndru në

magazinë përveç atyne që i përmende, a ka pasë edhe dikush tjetër?

PË. Kish qenë aty magazina ku ka qenë, uniforma mes kish qenë zbrastinë e mora vesht se janë tre romë aty tuj nejt. Atëherë më tregunë se janë të arrestum.

PY. Ti vetë a i pe këta të tre romët aty në magazinë me sytë e tu?

PË. Po, i kam pa. Të tretën ditë i kam pa.

PY. A të kujtohet diçka më shumë në lidhje me këta tre romët në magazinën e uniformave, ndonjë hollësi që të ka ra në sy që e ke pa ti vetë?

PË. Jo, nuk më ka ra tjetër gjë për derisa na kanë ndërru dhomën kur jam arrestu.

PY. A din diçka tjetër për këta të tre romët, për shembull, çfarë profesioni kanë pasë, prej nga kanë qenë, domethënë ndonjë informacion shtesë në lidhje me këta tre persona?

PË. Këta kanë qenë muzikanta me topana, me curle, me këto gjana

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të përpiqem t'ia freskoj kujtesën dëshmitarit në lidhje me disa të dhëna shtesë që na i ka dhënë ai për herën e parë që i ka parë këta persona në magazinë, duke përdorur deklaratën që e ka dhënë më përpara.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po. Vazhdoni.

[Trupi Gjykues dhe Sekretari i Gjykatës këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mendoj që mund ta heqim vizatimin prej ekranit.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, për momentin mundemi.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund ta hiqni prej ekranit vizatimin, Sekretar.

[Trupi Gjykues dhe Sekretari i Gjzkatës këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Përpara se të vazhdoni Prokuror, në mënyrë që të mund të përdorim referencat e duhura të të gjitha dokumenteve që përdoren, t’i japim një numër vizatimit që përdori dhe shënoi dëshmitar.

Sekretari këtij vizatimi, ju lutem, t'i jepni një numër prove.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, shënimet e bëra në dokumentin SITF00012878 do të evidentohen me numrin REG00954.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Mund të vazhdoni me numrin e dokumentit që kërkoni të vendoset në ekran.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dua që në ekran të vendosim dokumentin me numër SITF00012758 deri në numrin SITF00012789

RED2.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Prokuror, duhet të jemi të kujdesshëm në lidhje me informacion që mund ta shikojmë tani sa i përket hollësive të tjera sepse një informacion që u dha në lidhje me këta tre persona tani është redaktuar.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, e kam të qartë, atëherë ndoshta më mirë të kalojmë në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Sekretar të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

PY. Dëshmitar, pyetja ime është kjo. Në këtë deklaratë që e ke dhënë *[REDAKTUAR]* i ke treguar, i ke thënë

Prokurorit se:

"Në mbrëmje kanë filluar me keqtrajtimin e romëve se ata ishin dy vëllezër dhe një fqinj i tyre. Ata ishin muzikantë dhe babai i tyre quhej Nuredin. Mua më thanë që ata e njihnin njërin prej tyre si paramilitar sepse e kishin parë në një xhip ushtarak."

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Tani përfundova me dokumentin.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëherë ta heqim dokumentin nga ekrani

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, a ta rikujtoi pak ky dokumenti në lidhje me këto të dhënat shtesë me këta tre romët?

PË. Po merret në pyetje a ke pa edhe dikën, unë tregova se këta i kam unë në kujtesë fort mirë, dhe i kam parë rrahjet edhe krejt. Po ti në fillim pyete a ke pa dikënd, të tregova se i kam pa edhe tre romë aty. Këta i kanë rreh aty. Kjo është fakt i gjallë. Kam qejf kur të më bëni pyetje pak më i qartë, me i kuptue edhe unë me jua spjegu.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

PY. Kush e kreu arrestimin, kush ju arrestoi?

PË. Kanë ardhë nja tre, katër, mos të rrej, nuk jam tamam i sigurt, kanë qenë të policisë ushtarake dhe na i kanë lidhë duart.

PY. Po nga e kuptuat ju që ishin polici ushtarake dhe jo ushtarë të zakonshëm

PË. Se ato trakat në krah, në dallim prej UÇK-së.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

PY. A ju treguan se kush e kishte dhënë urdhrin për arrestimin, ju informuan për këtë?

PË. Jo unë e lypa për çfarë arsye jeni tuj më arrestu, a bën me ditë prej kujna. Pastaj më thanë "Do ta marrësh vesh më vonë". Nuk më tregunë.

PY. Pasi policët e policisë ushtarake ju lidhën brenda *[REDAKTUAR]* çfarë ndodhi pastaj?

PË. Nuk e di atë mbrëmje më duket e kanë pru dikën, janë konë tuj e rreh, e kam harru, kënd e kanë qenë tuj e rreh. Më kanë sjellë edhe mu nja tre-katër herë, a pesë herë a. Ratë sa jam kanë aty tuj nejt, se i lidhur, më kanë sjellë.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

PY. Ndërtesa ku ju çuan të nesërmen në mëngjes pas arrestimit a është e shënuar në këtë skeç. Nëse po, nëse duket në këtë skeç, a mund ta qarkoni me një rreth?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar e keni atë lapsin në dorë? Po në rregull.

DËSHMITARI: Paskem ba një gabim e paskem ba 2-shin nalt, në vend se me e ba pak më poshtë.

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Mund të flisni më qartë, çfarë deshët të thoshit me këtë?

PË. Këtu ku e kam bë rrethin është numri 1. Kjo ngjit është 2-shi, kah tek 2-shi është 3-shi.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull, do t'i marrim hap pas hapi. Tani do t'u vendosim numra nga e para. Domethënë janë këto numrat e rinj. Atëherë kërkojini dëshmitarit që të vizatojë numrin 1 se rrethi -- rrethin e quajti numri 1, me sa kuptova

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Shkruani numrin 1 për të shënuar dhomën ku ju kanë mbajtur juve të mbyllur.

PË. [Shënon]

PY. Faleminderit. Kjo ndërtesa tani dhomat e tjera të kësaj ndërtese përse përdoreshin nëse e dini?

PË. Kjo numri 1 ka qenë për të burgosurit edhe numri 3, për të burgosur. Këta numrin 2 e kanë përdorur më shumë për dajak, mbi [e pakuptueshme] për terapi.

PY. Shkruani numrin 3 tek dhoma që është përdorur për të burgosurit dhe numrin 2 tek dhoma që përdorej për dajakun.

PË. [Shënon]

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]
[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

PY. Dhe po e kapërcej pak këtë për një çast. Sa kohë ju mbajtën tek ajo dhomë? Deri kur ju mbajtën?

PË. Derisa kam ardhë në shtëpi temën.

[Seancë private]
[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Është një ndërtesë, një godinë që duam të na e identifikojë dëshmitari, nëse e njeh.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull, vazhdoni.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nëse ju lutem të vazhdojmë në ekran me 074390 deri në 074391.

Dhoma -- nëse mund ta zvogëlojmë edhe pak.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A e shihni qartë z. Dëshmitar?

PË. Shumë qartë jam tuj e pa.

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. A e njihni këtë godinë që paraqitet në fotografi?

PË. Po, në këtë dhomën e parë ka dritaret edhe në anë të djathtë edhe knejna, është dhoma ku kam qëndru unë, numër 1.

PY. Që të jemi që qartë, për cilat dritare - e keni fjalën për dritaren që është në anën e ngushtë, në murin e ngushtë të ndërtesës?

PË. Ka dritare edhe knejna edhe knejna. Nga të dyja anët, që kjo e para.

PY. Pra, kjo dritarja që këqyret knejna, çfarë -- nëse ja brenda çfarë shikon. Çfarë duket prej asaj dritareje? Kjo dritarja që shikon prej këtej. Domethënë kjo është një -- kjo është një nga dritaret e dhomës ku të kanë mbajtur mbyll apo jo?

PË. Po, kjo është dhomë me dy dritare

PY. Dhe nëse njeriu ndodhet brenda asaj dhome dhe shikon nga kjo dritare, çfarë sheh prej asaj dritare, nga sheh ajo dritare?

PË. Komplet shtabin e sheh. Kush hin e kush del, e, krejt, krejt, komplet.

PY. Po nga dritarja anësore e kësaj dritare, çfarë shihej?

PË. E ke si ndërtesë edhe një, këtej përballë, por s'kam qenë mbrena, se di ç'ka ka pasë. S'besoj se është përdorë, edhe e sheh rampën, rampën që hynë veturat brenda a diçka.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ju lutem që t'i tregojmë dëshmitarit fotografinë e dytë të këtij dokumenti.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Edhe kjo për të identifikuar?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Sekretar, ju lutem ta paraqitni.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

Të nderuar Gjykatës, dua që të paraqesim dhe një skicë tjetër, gjithashtu e vizatuar nga dëshmitari, e cila paraqet

më nga afër një zonë të shtabit për të cilën kam pyetje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lejohet.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Me lejen tuaj [e pakuptueshme] dokument me numër 05998 deri në numrin 059144 RED. 059118 deri në 059144. Dhe shfaqja dy me numër ERN 059119.

PY. Z. Dëshmitar, ta fillojmë me një formalitet. Nënshkrimin tuaj a e shihni në këtë dokument dhe nëse po, ku?

PË. Po, poshtë është.

PY. Faleminderit. Ju kujtohet që ta keni vizatuar këtë skicë *[REDAKTUAR]* gjatë intervistës me ZPS-në?

PË. Po.

PY. A mund t'i thoni Trupi Gjykues se çfarë paraqitet në këtë skicë, çfarë tregon kjo skicë?

PË. Këto janë dhomat ku kena qëndru edhe dhomat ku jena maltrajtu.

PY. Janë shënuar me numrin 1, 2 dhe 3. A mund t'i tregoni Gjykatësve në cilën dhomë ju kanë maltrajtu?

PË. Në dhomën numër 2, këtu.

PY. Në fund, në pjesën e poshtme të vizatimit, ka një skicë, ka një vizatim tjetër. Është shkruajtur diçka aty. Na e lexoni ju lutem se çfarë keni shkruar anash asaj, atij vizatimi ashtu si katror diçka?

PË. Kam shkruajtur "Tualet".

PY. Ju kërkoj ndjesë. Ajo që thatë është në anën e djathë, po

në anën e majtë poshtë e keni shkruar vertikalisht, anash. E keni shënuar edhe numrin 1 diçka.

PË. Këtë e kam shënuar se këtu ka qenë dera, se e kam bërë kah, se kjo derë ka qenë ka nalt, ndërmjet 1-shit edhe 2-shit, kur ke hy në korridor.

PY. Pra kjo është dera e dhomës 1, kështu?

PË. Po. Dhoma kur ke hy këtu, është dhomës 1 dhe dhomës 2. Përmbrenda atëherë i kanë dyer të tjera këto dhomat.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Tani mund ta heqim nga ekrani këtë provë e cila besoj se ka nevojë për një numër nga Zyra Administrative sepse ka mbajt shënime.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, por përpara kësaj, dua që dëshmitari të lexojë me zë atë që ka shkruajtur në gjuhën shqipe, majtas vertikalisht.

DËSHMITARI: Kjo është dera e dhomës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, dera e dhomës, në rregull, qartë. E kemi të qartë tani.

Z. Sekretar, ju lutem caktojini një numër kësaj skice ku janë bërë shënimet ose shënimi.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, shënimi i bërë në dokumentin me ERN 059119 do t'i caktohet numri REG00955.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit që e caktuar këtë numër z. Sekretar.

Gjithashtu për të sqaruar.

Z. Dëshmitar, e kam unë një pyetje për ju. Pra ne si Trupi Gjykues, se është ndonjëherë e vështirë me kuptu nga vijnë pyetjet. Kësaj radhe pyetja është nga unë. Më saktë nga i gjithë Trupi Gjykues.

Kur e shikojmë këtë skicën, vizatimin që ju e keni vizatuar, hapësira ose më saktë kemi dhomat 1, 2, dhe 3. Por, midis tre dhomave është një hapësirë, jo -- po e them gabim. Jo. Midis dhomës 1 dhe 2 ka një hapësirë. Ky është një korridor nëse e kam kuptuar qartë dhe në fund të këtij korridori keni vizatuar një si gjysëm rrethi ashtu. Kjo është derë?

DËSHMITARI: Derë është.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A mund ta shënoni me një shkronjë, me shkronjën "A", për të qenë të sigurt që po flasim, ah është kjo. E kishit për këtë. A mund të tregoni në të njëjtin korridor, a ka dyer të tjera aty?

DËSHMITARI: Po, është tjetra përballë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe shënoi me germat "B" dhe "C". Po domethënë midis dhomës 2 dhe 3 do të thoni?

DËSHMITARI: Jo, dhoma e parë është ku kam qenë i mbyllur unë, edhe dhoma dy ku jena maltrajtu. Këtu është korridori në mes të dyjave. A dhoma 3 e ka derën prej përjashta, kënejna përjashta, këtu a konë, në atë tjetër.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë, shumë mirë. Faleminderit. Tashti, ky korridori ku janë dyert, dera A dhe dera B, këtu në fund të korridorit keni vizatuar një gjysmë rrethi, është një gjysmë rrethi aty i shënuar, në njërën anë. Ç'ka është ajo?

DËSHMITARI: Kjo ishte dera kur hishim në korridor.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shënojeni ju lutem me shkronjën "D".

DËSHMITARI: [Shënon]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë, atëherë, kur e kalon njeriu derën D, pra kur e kalonte derën D dhe hynte pra, në korridorin A dhe B, kur e kalon derën D, kur del pra prej asaj, a ndodhesh jashtë a brenda?

DËSHMITARI: Jashtë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këtë deshëm të dinim. Faleminderit.

[Anëtarët e Trupit Gjykues dhe Sekretari këshillohen]

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shënimet që i janë bërë këtij dokumenti kanë marrë tashmë një numër dhe do të mbajë po të njëjtin numër. Do të ruhet tani sërish me këto shënime shtesë të cilat i bëri dëshmitari. Po me të njëjtin numër do të ruhet. Në rregull.

Z. Prokurori keni fjalën.

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Faleminderit, Dëshmitar. Mendoj që tani e kemi identifiku vendin ku jeni mbajt aty brenda në shtab dhe na e përshkruat edhe planimetrinë e vendit ku jeni mbajt. Na thatë që jeni mbajt në dhomën numër 1. A mund të na e përshkruash brendinë e dhomës?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dëshmitar, përpara se të fillosh me përgjigjen, prit një moment.

Prokuror, a është kjo pjesë diçka që mund ta bëjmë në seancë publike?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po mund ta bëjmë në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëherë po kalojmë në seancë publike.

Dëshmitar, tani do të kalojmë në seancë publike përsëri, prandaj të lutem të kesh kujdes që të mos përmendësh informacion që mund të të identifikojë.

Z. Prokuror e keni fjalën menjëherë sa të kalojmë në seancë publike.

~~[Seancë e hapur]~~

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, tani jemi në seancë publike. Na tregove se dhoma e shënuar me numrin 1 në këtë vizatim është dhoma ku je

mbajtur ti. A ka pasur mobilie aty në dhomë?
PË. Ka pasë plafa, qebe për fillim. Batanije domethënë, veç për në tokë vPY. Prej çfarë materiali ka qenë dyshemeja, toka?
PË. Toka ka qenë zall, se ka qenë e betonume po ka qenë betoni i prish se ato kanë ndërtesa të vjetra. Ama ka qenë sikur zall, dhé.
PY. Më herët na tregove që ka pasë dy dritare. A mund të na i përshkruash këto dy dritare. A ka në pasë xham?
PË. Sa mbaj mend nuk kanë pasë xham.
PY. A kanë qenë të hapuna apo të mbylluna, a ke mujt me kalu nëpër dritare?
PË. Jo s'ke mujt. Kanë qenë me hekra.
PY. Na tregove që s'ka pasë mobilje aty se ka pasë plaga, batanije ose qebe. Ku keni fjete ju?
PË. Q'aty në tokë, q'ashtu.
PY. A keni mund me i përdor batanijet për me fjete mbi to?
PË. Për fillim, po, nja dy-tre ditë, atëherë na i kanë hekë krejt.
PY. Po në lidhje me ushqimin, çfarë ushqimi ju kanë dhënë?
PË. Për besë me të tregu të vërtetën kur kam pasë hëngër, ndoshta një herë në dy javë, ndoshta në javë, na kanë dhënë për sevab të zotit një grimë, por s'e mbaj mend çfarë kam hëngër. Veç a mbaj mend dajakun. Se ushqimin e kam pasë harru krejt.

PY. Do të mbërrimë edhe te ajo pjesë. Vetëm disa aspekte të tjera dua t'i sqarojmë në fillim. Gjatë kohës që të kanë mbajtur aty, a të kanë dhënë ujë?

PË. Ujë na i kanë lënë do shishe aty. S'kemi pasë, pak krejt. Jemi kanë gjashtë-shtatë vetë ka i herë nëntë, ka i herë 12 veta të burgosur. Tri-katër shishe si kanë dalë kujna. Edhe pa bukë. Diçka a dashtë me e pi.

PY. Po kur ju sosej uji a mund të kërkonit që t'ua mbushnin prapë shihet me ujë?

PË. Kërkonim po varet kur deshin me na dhonë. Krejt varejt prej tyne.

PY. Mbasi na e përshkruajte dhomën e ndalimit, dhe përmende që aty kanë qenë edhe njerëz të tjerë në momente të ndryshme, numra të ndryshëm, kur të çuan *[REDAKTUAR]* nga magazina aty te dhoma ku të kanë mbajtur, a gjetët dikënd tjetër aty në dhomë, në dhomën numër 1?

PË. Kam harru, veç e di se romët i kanë pasë pru q'atë ditë aty, se nuk i mbaj mend ndoshta tamam se ka kalu një kohë e gjatë. Romët e di, më duket i kam gjatë aty. Se i kanë pru prej magazine.

PY. Sa e madhe ka qenë dhoma përmbrenda, domethënë s'ke pasë metër me vete, atë e di, po me sa të kujtohet sa e madhe ka qenë kjo dhomë?

PË. Po muj me thënë, tri me tri, a tri me tri e gjysë, nuk e mbaj mend unë nuk e kam majt, po afërisht me sy, më duket tri

me tri. Ndoshta më e madhe pak, një metër ndoshta, gjysmë metri më e vogël, se di. Ama tri metër njëna anë, po, të sigurt, duhet me e pasë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Prokurori dua t'ja bëj dëshmitar një pyetje për qartësim.

Dëshmitar, për procesverbalin, është faqja 65, më fal faqja 66. Dëshmitar, ju thatë që keni pasur qebe fillimisht për disa ditë në fillim e mandej i kanë hek qebet. Kush i kanë hek qebet prej aty?

PË. Kanë dhënë urdhër këta të mëdhejt ushtarëve për me i hek. Se janë anku ç'ka vijshin prej lufte të plagosun për ç'ka me ju lënë qebe këtyne, gjoja se jena ne spiuna, kur “na tuj hongër plumba atje e këtej me ju lanë me fjetë botë”. Edhe i kanë detyru me na i hek.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. E kam të qartë.

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. E di që ka kaluar shumë kohë dhe ndoshta Trupi Gjykues do të më lejojë që tua freskoj memorien në lidhje me atë pikë. Po Dëshmitar, a të kujtohet, mendo në qoftë se të duhet kohë, mendo pak, a të kujtohet identiteti i ndonjonit apo i cilitdo person tjetër që është mbajte aty në dhomë me ty?

Ndoshta duhet të kalojmë në seancë private për këtë pjesë të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

[mikrofoni çaktivizuar]

Të kalojmë në seancë private, z. Sekretar.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, mund t'i heqësh dëgjueset të lutem?

Përpara se t'jua jap fjalën Mbrojtës, mund të edhe ta nxjerrim përkohësisht nga salla dëshmitarin, sepse hamendësoj çfarë mund të jetë përmbajtja e asaj që mund të na thoni edhe në qoftë se ajo do të ndikojë te dëshmitari. Në qoftë se keni dyshime të tille atëherë ndoshta është më mirë ta nxjerrim përkohësisht dëshmitarin nga salla.

Z. Dëshmitar, faleminderit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e kam plotësisht të qartë, as unë as Gjykatësit e tjerë në qoftë se kur i ka dëgjueset në tavolinë dëshmitari mund të dëgjojë përmes përkthimit atë që thuhet.

Z. Avokat, keni fjalën.

Z. AOUINI: [Përkthim] Do të paraqes një kundërshtim të fortë, pse u përdor dokumenti i dytë ishte për arsyen se pse u mbajtën këta njerëz. Dokumenti i dytë përmban edhe shumë hollësi të tjera, edhe prek edhe tema të tjera. Ne e kundërshtojmë këtë fuqimisht. Në qoftë se përdor 2-3 dokumente njëkohësisht edhe i kërkon dëshmitarit t'i konfirmojë ato në

një mënyrë që e influencon dëshmitarin në një mënyrë të papërshtatshme. Duhet t'i bëjmë gjërat hap pas hapi në mënyrë që të sigurohemi që paraqitja e provave të bëhet në mënyrë të e drejtë.

Pyetja ishte se kush ishte në dhomë me dëshmitarin. Duhet një herë të vërtetohet, konfirmohet identiteti dhe nuk duhet t'i jepet dëshmitarit sfond, në lidhje me përgjigjen. Nuk është kjo mënyrë, për mendimin tonë sesi duhet të paraqiten provat.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, Avokat i Mbrojtjes.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Atëherë do ta bëj një nga një në faqen tjetër të këtij dokumenti dëshmitar thotë "Po ky person qëndroi me dhomën me mua dhe pastaj u hoq prej dhome".

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kështu e dita edhe unë. Nuk mendoj që Prokurori bëri diçka të papërshtatshme duke marrë parasysh njohurinë që kemi ne për dokumentet që do të përdoren. Por në përgjithësi, pajtohem që duhet t'i kalojmë gjërat, hap pas hapi dhe mendoj se po bëjmë kështu.

Ndoshta për herën e ardhme duhet një herë të konfirmojë dëshmitar në qoftë se ka qenë aty po i dhënë hollësi të tjera. Por Avokat i Mbrojtjes përdorimi i dokumenteve bëhet për ta rifresku memorien e dëshmitarëve.

Nuk e pashë një gjë të papërshtatshme, të padrejtë se

Prokurori po vendoste fjalë në gojën e dëshmitarit.

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]* Nuk duhet t'ja japim këto të dhëna dëshmitarit. Mund t'ja bëjmë pyetjen dhe pastaj kur t'ja rifreskojmë memorien mund t'i përdorim këto, sepse ndoshta dëshmitari flet për dikë tjetër.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E dëgjova kundërshtimin tuaj edhe mendoj se mund të vazhdojmë. Si çdo herë unë i kërkoj Prokurorit që të ketë parasysh thelbin e kundërshtimit të Mbrojtjes. Pra, me fjalë të tjera që mos t'i jepet dëshmitarit shumë informacion kur nuk është e nevojshme.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] E kam të qartë tani. Mund të hiqet dokumenti nga ekrani.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare, a mund ta ktheni dëshmitarin në sallë.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se u ktheve Dëshmitar.

DËSHMITARI: Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani do t'ja jap përsëri fjalën Prokurorit që të vazhdojë me

pyetjet për ju, edhe 10 minuta dhe mandej do e kemi pushimin e drekës. Faleminderit.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

I kam referencat për dokumentet në shqip dhe duke mbajtur parasysh kundërshtimet e Mbrojtjes ndoshta është mirë që ta lexoj pjesën në anglisht dhe të përkthehet me ndihmën e

përkthyesit ajo pjesë. Kjo ndoshta edhe e zgjidh problemin e kundërshtimeve të Mbrojtjes.

Z. AOUINI: [Përkthim] Po, e mirëpresim këtë propozim të Prokurorit.

[Anëtarët e Trupit Gjykues dhe Sekretari këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund të vazhdojmë kështu, mirëpo çfarë mund të ndodhë është se mund të ketë dallime në përkthim për sa i përket tekstit që kemi në ekran. Ndoshta kjo nuk do të ndryshojë thelbin por mund të përdoret ndonjë fjalë tjetër nga përkthyesit. Prandaj, duhet ta kemi këtë parasysh, këtë kusht.

Z. AOUINI: [Përkthim] Atëherë, propozoj që në dokumente si ky, ku kemi pyetje dhe përgjigje ta zmadhojmë faqen vetëm në atë pjesë që i duhet prokurorit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo është një mënyrë mjaft e ndërlikuar për ta vendosur vetëm atë pjesë në ekran. Mendoj që do të vazhdojmë me përkthim dhe në qoftë se del ndonjë problem atëherë do ta zgjidhim në vend.

Kemi edhe disa minuta z. Prokuror. E keni fjalën përsëri. Duhet të keni parasysh se jemi afërt kohës së pushimit të drekës

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Në mesin e personave që mbaheshin aty me ty, më herët e ke përmendur edhe një person nga Drenica, i cili kishte ardhur

prej Gjermanie në Durrës për ta vizituar dhe për t'u kujdes për familjen e vet. Dhe se ai person ka përfundu në të njëjtën dhomë aty në burg ku keni qenë edhe ju. Domethënë është një person tjetër një person i Drenicës i cili kishte ardhë nga Gjermani në Durrës për ta ndihmuar familjen.

PË. Po. Ka qenë po tash ka nja pesë-gjashtë vjet më duket është i vdekun.

PY. Po a ja din emrin këtij personi?

PË. Po e kam harru. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

PY. Faleminderit.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ndoshta ky është një moment i përshtatshëm për të bërë pushimin e drekës, sepse mbas kësaj do të kaloj në një temë tjetër. Kemi dhe tre minuta z. Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Prokuror, -- z. Sekretar a mund të kalojmë një herë në seancë publike.

~~[Seancë e hapur]~~

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike, i nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Dëshmitar tani do të bëjmë një pushim prej një orë e

gjysëm ç'ka do të thotë se do të shihemi përsëri në orën 14.30. Të uroj pushim të këndshëm të drekës dhe shpresoj që të pushosh pak. Faleminderit

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo, jo.

Z. Shala, a ke diçka për t'i thënë Gjykatës?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e nderuar Gjykatëse, kam nevojë vetëm një konsultim të vogël me Mbrojtjen time. Në qoftë se është e mundshme të më telefonojnë. Vetëm aq. Ju faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju Faleminderit z. Shala. E shoh që Mbrojtja jote e ka marrë parasysh kërkesën. Ka marrë shënim përpara se të fillojmë pushimin deri në orën 14.30.

Z. Shala, mbasdite, kur do t'ju pyes se e dëgjoni dëshmitarin, mjafton që të thuash "E dëgjoj". Nuk ka nevojë ta përsëritësh që mund edhe ta shohësh shumë mirë. Në rregull? Faleminderit.

Atëherë këtu mbyllet seanca. Faleminderit.

--- Pauza e drekës fillon në orën 12:59

--- Seanca rifillon në orën 14.30

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se u rikthyet. Do të vijojmë me dëshminë e Dëshmitarit numër 1. Nuk shoh ndryshim. Më falni, vërej një ndryshim në ekipin e

ZPS-së.

Z. MINICIS: [Përkthim] Po. Z. Whiting nuk është me ne sot këtë pasdreke.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, e mbajtën shënim.

Vë re se Mbrojtësi i Viktimave ka të njëjtën përbërje të ekipit.

Në të majtë vë re që anëtarët e Mbrojtjes tundin kokën. Do të thotë që është e njëjta përbërje.

Z. Shala, më dëgjoni në rregull? Ju shoh që pohoni me kokë. Mjafton për tani. Thjesht për të qenë të sigurt mund t'jua dëgjoj edhe zërin ju lutem?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju dëgjoj mirë, e Nderuar.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Znj. Asistente e sallës, ju lutem shoqërojeni Dëshmitarin të hyjë sallë.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Znj. Kryetare.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo. Znj. Asistente e sallës, prisni, ju lutem.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Me lejen tuaj.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Patjetër.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, lidhur me atë që thatë ju në

fund Z. Shala patëm një bisedë me të. I shpjeguam që me videolidhjen ai ka të drejtën të dëgjojë dhe të shikojë të gjithë seancën. Edhe ne i kërkuam që ai ta respektojë kërkesën tuaj që i bëtë në fund të seancës. Po i shpjeguam që nëse ka ndonjë problem të mund të ngrejë dorën dhe të thotë që "ju dëgjoj", apo "nuk ju shikoj". Por pa folur për Dëshmitarin.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ajo që thashë unë ishte e qartë. Mund të interpretohet pastaj në shumë mënyrë, por është një kontroll, ajo që bëj unë është thjesht një kontroll teknik sa i takon lidhjes. Ne gjithmonë kontrollojmë paraprakisht nëse çdo duket mirë dhe lidhje është mirë. Është thjesht një kontroll shtesë. Nëse z. Shala, do ta kisha thënë vetëm herën e parë, nuk do të kisha bërë koment, por nuk dua ta dëgjoj katër herë gjatë ditës.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Pra, ideja është që është në rregull.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po unë e pyes nëse më dëgjon, në rregull, z. Shala mund të thotë që e dëgjon, e dëgjon edhe Dëshmitarin, kaq, kështu mund të vazhdojmë.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Në rregull.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëherë mund të vijojmë.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

se u rikthyet z. Dëshmitar.

DËSHMITARI: Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të vijojmë tani me pyetjet që i bën Zyra e Prokurorit të Specializuar. Hë për hë jemi në seancë publike. Do t'ia jap fillimisht fjalën z. Prokuror.

Z. Prokuror.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, besoj se mund t'ia nis me seancë publike, të vazhdojmë paksa në seancë publike përpara se të kalojmë në seancë private. Pra, nuk ka problem. S'ka rrezik të vazhdojmë në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Thjesht për t'u siguruar. Z. -- Nuk e di. Z. Shala e dëgjuat mirë Prokurorin?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] [e padëgjueshme]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po nuk po ju dëgjoj unë juve tani. Prandaj duhet bërë ky kontroll.

Nuk e di a e dëgjojnë ndonjë të pranishmit Z. Shala? Jo nuk e dëgjojmë.

Z. Shala, a e keni të ndezur mikrofonin?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] A më dëgjoni?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani, po, ju dëgjojmë. Ju dëgjojmë shumë mirë. Faleminderit.

A e dëgjonit dot Prokurorin kur po fliste, dëgjohej?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] E dëgjoj, por nuk jam dakord me Prokurorin, e nderuar Gjyqtare se o të bëjmë, përderisa nuk përmenden emrat dhe identiteti i dëshmitarëve, o ta bëjmë gjithë publike o ta bëjmë privat.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. një moment ju lutem.

Z. Shala, ju lutem. Ju lutem përgjigjuni pyetjeve që unë ju bëj dhe jo të tjerave.

Por mua më mjafton të di që e dëgjoni z. Prokuror. Faleminderit.

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, përpara pushimit po diskutonim për identitetin e disa prej personave të cilët ishin po ashtu të ndaluar me ju. Përpara se të kalojmë në një temë tjetër, në një ditë tjetër që keni qëndruar, dëshiroj që të përfundoj disa pyetje lidhur me mënyrën se si ju dhe ata të tjerët të cilët i përmendët me emër, por edhe të tjerë që s’i përmendët me emër u trajtuar. Pra, kushtet në të cilat ju kanë mbajt aty.

Pyetja e parë është kjo: Nëse ju apo ndonjë person tjetër i bashkëburgosur, le të themi, me ju aty kishit nevojë të shkoshit në tualet, ku shkonin për këtë punë?

PË. U deshka me dal prej dhomës, prej korridorit, në oborr e me shku në banjo, jashtë.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar] Kërkoj

që të paraqitet dokumenti REG000954 në ekran.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Me çfarë qëllimi?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Për të identifikuar vendndodhjen e tualetit për të cilin sapo folëm.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Po, mund të vazhdoni.

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, ju lutem, mund të shënoni me shkronjën "T" tek ai vendi ku shkonit në tualet. Mund t'ju ndihmojë edhe Asistentja e sallës mbase për këtë.

PË. Sa e vendosa.

PY. Shumë mirë.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mund ta heqim tani dokumentin nga ekrani.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë, por duhet të ruajtur nga Sekretari i Gjykatës. Z. Sekretar, nëse është e mundshme dhe e pranueshme që të shënojmë se të ketë të njëjtin numër që i keni caktuar, përfshirë tani edhe këtë shënim shtesë.

Në rregull z. Sekretar?

[Trupi Gjykues dhe Sekretari i Gjykatës këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, në rregull. Mund të vazhdoni. Z. Prokuror keni fjalën.

Z. DE MINICIS: [Përkthim]
PY. Ju dhe personat e tjerë të ndaluar aty, ishte që mbaheshit në dhomën 1, ishte besoj dera ishte e bllokuar?
PË. Po, e bllokuar ishte edhe ka pas roje aty te dera.
PY. Po atëherë çfarë procedure ndiqnit nëse ju duhej me shku në tualet?
PË. U deshka me e pyet rojën. Roja e pytka dikan ma të madh, për me ia dhënë lejen.
PY. Pastaj ju lejojshin me shku me në tualet mbasi merrej leje?
PË. Mbasi u merrka leja, po. Në qofte se ka dash me të lënë, por rrallë ka ndodh me na nalu.
PY. A ju shoqëronte kush nga dhoma ku ju mbanin të ndaluar te tualeti apo shkonit vetë?
PË. Jo, kena pas roje mbrapa.
PY. Më herët na thatë se kur ju arrestuan ju lidhën disi, ju lidhën me ca lidhëse të çizmeve ushtarake. Kur ju mbanin në dhomën 1, duart i kishit të lidhura, a ju mbanin të lidhur në njëfarë soj.
PË. Unë, personalisht, unë shumicën e kohës i kam pastë t'lidhtë. Personalisht unë.
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
PY. A ju kujtohet nëse të ndaluarit e tjerë që ishin në atë

dhomë i mbanin të lidhur a jo?
PË. Jo, përveç meje asnjë. Unë veçantë jam konë aty, se m'i kanë lidh. Nuk e di pse.
PY. Gjatë ndalimit tuaj aty, ndonjë sapun a jua kanë dhënë me u la?
*[REDAKTUAR]* që atëherë na kanë nxjerrë një roje se e kanë pas ndërru. Ai na ka nxjerrë jashtë, por jo sapun, veç me ujë të ftohtë e kanë pas një shator, si mbulesë përjashta në oborr, q'aty kem hi; jena la me ujë të thjeshtë, normal, pa asnjë gjë tjetër. Sa me hek q'atë gjak.
PY. Po përpara *[REDAKTUAR]* a ju kanë leju me u la?
PË. Jo, jo, asnjëherë. As me i la sytë, as me u la.
PY. Po furçë me pastru dhëmbët?
PË. S'kem pa asigjo me sy na.
PY. Po ndonjë palë tesha të pastra me ju dhënë?
PË. Jo, asnjë gjë.
PY. Gjatë qëndrimit brenda asaj dhomës, a bisedonit dot lirisht me personat e tjerë të mbajtur të ndaluar aty?
PË. Me fol tinas se ashiqare fort me fol kanë mujt me na maltrajtu se shka folët, tek folët, kriste dajaku. Se të merrshin në pyetje. E vetshin tjetrin çka keni fol, çfarë informata i dhatë, tek i dha e kështu rrishim ma mirë rehat nuk folshim me njoni-tjetrin [e pakuptueshme].
PY. A mund të na përshkruani, a ju kujtohet dera e dhomës 1

ku ju kanë mbajt të ndaluar, ç'pamje kishte ajo derë?

PË. Dera ka qenë e ndreqme me dërrasa, [e pakuptueshme] ata drunat që janë kështu edhe pjesë-pjesë. Kanë pas vijat e çelta sa me mujt me e pa diçka.

PY. Pra, edhe ju vetë mund të shihnit përtej derës nga brenda ndërtesës?

PË. Po, ka pak shihnim. Jo bash por mujshim me e pa diçka aty-këtu.

PY. Z. Dëshmitar, pak më herët në faqen 69 të transkriptit të punimeve sot në Gjykatë --

Znj. Gjykatëse nëse mund të kalojmë ju lutem në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Sekretar, ju lutem, të kalojmë në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, do të kalojmë tani në seancë private, pra, pastaj mund të flisni më lirisht.

DËSHMITARI: Në rregull.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F631*

Z. DE MINICIS: [Përkthim]

PY. A ju akuzuan ndonjëherë se ishit spiun gjatë kohës që ju kanë mbajt aty në Kukës?

PË. Po kur kalojshin njerëz nga dritaret spiuna, na shajshin nënën e tërë të zezat se i kishin rrejt këta se kush jem. E unë nuk e di për çfarë vepre pasna spionu, kën e kam marrë në qafë. Le të më tregojnë, në qoftë se jam konë po e pranoj. Le të ma gjejnë një fakt. Një fakt sa grimca le të ma gjejnë, sa

maja e gjilponës të ma gjejnë unë po e pranoj çdo gjë. Edhe se s'e kam bo, kam me e pranu. Edhe kam me i dalë në mbrojtje. Kanë ardh njerëz që vijshin prej frontit të plagosun kur vijshin, dojshin me na hi me thika me na pre brenda në dhomë, s'i leka roja. Çfarë rreziqesh çka kena pa tmerr na. Për fjalë të këtynve, për dajak të këtynëve se na kanë bo. Ma shumë o konë tuta se dajaku, se deshën natën me na hi, ka 10-15 ushtarë me na hi me zor, por na mbrojka roja. Se i kishin gjindja familjet e vramë krejt. Ai s'menojke, veç menojka se je spiun edhe dojka me [e pakuptueshme] fare. Kish të drejtën ai plot, ai s'kish faj i shkreti se e kishin rrejt këta të tjerët. Se edhe unë ndoshta kish vepru q'ashtu me m'thonë spiun kur ma kanë vra krejt familjen. Por jo me e marrë në qafë pa të pas borxh asnjë send.

PY. Ju kuptoj.

PË. Nuk baj fajtorë unë. Ushtari ka urdhra, s'ka qare pa i zbatu. Ai i shkreti s'ka faj.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Dëshmitar, për sot të falënderoj për kohën. Do ta përfundojmë seancën këtu dhe do të vazhdojmë nesër në orën 90.30. T'ju përkujtoj se brenda kësaj kohe nuk duhet ta diskutoni dëshminë tuaj me askënd. Dhe të këshilloj që të pushosh. Shihemi përsëri nesër.

Sekretarja do t'ju ndihmojë për të dalë nga salla. Do t'ju shoqërojë dhe stafi i Zyrës Administrative do të jetë me ju.

DËSHMITARI: Okej, faleminderit. Kalofshi mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Përpara se ta përfundojmë ditën e sotme të punës, do t'ju drejtohem edhe një herë palëve.

Prokuror, keni diçka për të ngritur?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] S'kemi.

Z. LAWS: [Përkthim] S'kemi.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit. Për planifikim a ka ndonjë ndryshim në kohën që parashikon Prokurori i duhet me këtë Dëshmitar, a mund të na tregojë?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po e pyes Prokurorin: Z. Prokuror, keni ndonjë ndryshim?

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Për momentin, koha e përllogaritur është e njëjtë. Do ta shikojmë edhe një herë transkriptin dhe nesër në mëngjes do t'ju tregoj më saktësisht sesa kohë do të na duhet.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Atëherë për momentin si qëndrojnë punët nuk mendoj që do të ndodhë diçka para të premtes. Se përfundojmë deri para të premtes.

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mënyra se si po zhvillohen ngjarjet, ndoshta mund të përfundojmë edhe të enjten, por do të shikojmë deri atëherë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëherë, ju uroj të gjithëve mbrëmje të këndshme dhe shihemi të nesërmen. Nesër në orën 09.30. Seanca përfundon këtu. Të gjithë në këmbë.

--- Seanca mbyllet në orën 16.01